



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-230**

**PËR AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR AGJENCINË E MENAXHIMIT EMERGJENT**

**KREU I**  
**DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, strukturimin, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyrën e financimit të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

**Neni 2**  
**Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria e Punëve të Brendshme;

1.2. **Ministër** - Ministri i Punëve të Brendshme;

1.3. **Agjencia** - Agjencia e Menaxhimit të Emergjent;

1.4. **Qendra 112** – Qendra Operative Emergjente Regjionale nënkupton strukturën operative të agjencisë së shtrirë në nivel lokal, e cila përfaqëson një zonë të caktuar gjeografike prej dy e më shumë komunave;

1.5. **Drejtori i Përgjithshëm** – drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent;

1.6. **NJPZSH** – njësi profesionale operative, e cila merr pjesë në intervenimet për fikjen e zjarrit, shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale në situata emergjente;

1.7. **SMSHN**- Strukturat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

1.8 **Zyrtar që kryejnë detyra operative dhe profesionale** – zyrtarët që punojnë në lëmin e mbrojtjes së komuniteteve përmes koordinimit dhe integritit të të gjitha aktiviteteve të nevojshme për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e kapaciteteve për përballimin e situatave ekstreme të cilat mund të lëndojnë apo vrasin numër të madh të njerëzve, të shkaktojnë dëme të mëdha në të mira materiale dhe ta çrregullojnë sistemin e jetës së komunitetit.

2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin ashtu siç përcaktohet në Ligjin për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ligjin për mbrojtje nga zjarri, Ligjin për zjarrfikje dhe shpëtim, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

## **KREU II**

### **AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT**

#### **Neni 3**

##### **Themelimi dhe statusi i Agjencisë**

1. Agjencia themelohet si organ i pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Agjencia ka statusin e personit juridik.
3. Agjencia vepron nën autoritetin e drejtpërdrejtë të ministrit të MPB-së dhe kryen veprimtari për ndërtimin, ruajtjen ngritjen dhe avancimin e sigurisë së përgjithshme në fushën e menaxhimit emergjent, dhe ofrimin e shërbimeve profesionale.
4. Selia kryesore e agjencisë është në Prishtinë.

## **Neni 4**

### **Simbolet e Agjencisë**

Agjencia ka flamurin, stemën dhe uniformën e vet të cilat propozohen nga drejtori i Përgjithshëm dhe miratohen nga ministri.

## **Neni 5**

### **Parimet e Menaxhimit Emergjent**

1. Agjencia vepron në bazë të parimeve të pranuara ndërkombëtarisht si në vijim:

1.1. **Gjithëpërfshirës** - menaxherët emergjent njohin dhe marrin parasysh të gjitha rreziqet, të gjitha fazat, të gjitha palët e interesit dhe të gjitha efektet e ndërlidhura me të gjitha llojet e fatkeqësive;

1.2. **Progresiv** – menaxherët emergjent parashikojnë fatkeqësitë e ardhshme dhe ndërmarrin masa parandaluese dhe përgatitore për krijimin e komuniteteve rezistuese ndaj të gjitha llojeve të fatkeqësive dhe me aftësi ripërtëritëse pas tyre;

1.3. **I udhëhequr nga rreziku** – menaxherët emergjent përdorin parime të forta të menaxhimit të rrezikut - identifikimin e rrezikut, analizën e rrezikshmërisë dhe analizën e efektit - në caktimin e prioriteteve dhe resurseve;

1.4. **Integrues** – menaxherët emergjent sigurojnë unifikim të përpjekjeve midis të gjitha niveleve të qeverisjes dhe të gjitha elementeve të komunitetit;

1.5. **Bashkëpunues** – menaxherët emergjent krijojnë dhe mbështesin marrëdhënie të gjëra dhe të sinqerta midis individëve dhe organizatave për të inkurajuar besim, punë ekipore, arritje të konsensusit dhe lehtësim të komunikimit;

1.6. **Koordinues** – menaxherët emergjent sinkronizojnë aktivitetet e të gjitha palëve relevante të interesit për arritjen e qëllimit të përbashkët;

1.7. **Fleksibël** – menaxherët emergjent përdorin qasje kreative dhe inovative në zgjidhjen e sfidave të fatkeqësive;

1.8. **Profesional** – menaxherët emergjent çmojnë qasjen e mbështetur në shkencë dhe dije të bazuar në edukim, trajnim, përvojë, punë etike, administrim publik dhe përmirësim të vazhdueshëm.

## **Neni 6**

### **Udhëheqja dhe autoriteti**

1. Agjencia udhëhiqet nga drejtori i Përgjithshëm dhe vepron nën autoritetin e ministrit.
2. Autoriteti i ministrit nuk përfshinë menaxhimin operativ të agjencisë.
3. Për administrimin dhe menaxhimin e agjencisë, drejtori i Përgjithshëm i përgjigjet dhe i raporton ministrit.
4. Drejtori i Përgjithshëm e informon Ministrin njëzetekatër (24) orë në ditë, shtatë (7) ditë në javë.

## **Neni 7**

### **Emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorëve**

1. Kandidatët për pozitën e drejtorit të përgjithshëm dhe dy (2) zëvendës drejtorëve të Agjencisë propozohen dhe përzgjidhen nga Komisioni i themeluar nga ministri.
2. Drejtori i Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Agjencisë emërohen për një periudhë kohore prej pesë (5) vitesh, me mundësi vazhdimi pas çdo pesë (5) vitesh, nga autoriteti që i ka emëruar.
3. Nëse Drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm të Agjencisë iu përfundon mandati në vitin kalendarik të zgjedhjeve të përgjithshme, atëherë qëndrimi i tyre në detyrë do të zgjatet në mënyrë automatike për një (1) vit pas certifikimit të zgjedhjeve.
4. Komisioni i propozon ministrit kandidatët për emrin në pozitën drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë, ministri në një rën nga mbledhjet e qeverisë propozon kandidatin për këtë pozitë, ndërkaq qeveria i rekomandon kryeministrit kandidatin për drejtor të Përgjithshëm të Agjencisë. Drejtorin e Përgjithshëm e emron kryeministri.
5. Komisioni i propozon drejtorit të Përgjithshëm kandidatët për emërim në pozitën e zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, ndërsa drejtori i Përgjithshëm i rekomandon ministrit kandidatët për zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Agjencisë. Zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të Agjencisë i emron ministri.
6. Themelimi, përbërja dhe procedurat e komisionit rregullohen me akte nënligjore të nxjerr nga ministri.

## **Neni 8**

### **Kriteret për përzgjedhjen dhe emërimin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendës Drejtorëve**

1. Kriteret për përzgjedhje dhe emërim të drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve janë:

- 1.1. të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të jetë i diplomuar në një nga universitetet e akredituara ose të ketë diplomë të nostrifikuar;
- 1.3. të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë;
- 1.4. të ketë përvojë pune menaxheriale se paku pesë (5) vite në fushën përkatëse;
- 1.5. të mos ketë konflikt interesi me detyrën apo siç parashihet me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

2. Secili kandidat për pozitën e drejtorit të Përgjithshëm dhe zëvendës drejtorëve të Përgjithshëm, duhet t'i nënshtrohet verifikimit të sigurisë sipas ligjit të aplikueshëm.

## **Neni 9**

### **Lirimi dhe shkarkimi nga detyra i Drejtorit të Përgjithshëm dhe Zëvendësdrejtorëve**

1. Drejtori i Përgjithshëm apo zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm, lirohen apo shkarkohen nga detyra nga autoriteti i cili i ka emëruar, për njërin nga arsyet e mëposhtme:

- 1.1. është dënuar për vepër penale;
- 1.2. arrin moshën për pension;
- 1.3. jep dorëheqje;
- 1.4. për shkak të pamundësisë së ushtrimit të detyrës për një periudhë kohore jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj;
- 1.5. me mbarimin e mandatit;
- 1.6. për shkak të performancës jo të mirë të dokumentuar.

2. Kur ekziston dyshim i bazuar se drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, ka kryer vepër penale apo për ndonjërin nga arsyet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, ministri mund ta suspendojë menjëherë drejtorin e Përgjithshëm dhe ia paraqet kryeministrit të gjitha faktet për

dhënien e suspendimit. Kryeministri vendos lidhur me shkarkimin apo ndërprerjen e suspendimit.

3. Në rastet e lirit, shkarkimit apo suspendimit të drejtorit të Përgjithshëm, ministri menjëherë emëron njërin nga zëvendës drejtorët e Përgjithshëm si ushtrues detyre të drejtorit të Përgjithshëm.

### **Neni 10** **Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm**

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë është përgjegjës për:

- 1.1. administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm të agjencisë;
- 1.2. punësimin dhe sistemimin e personelit;
- 1.3. nxjerrjen e akteve nënligjore dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të agjencisë;
- 1.4. menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar agjencisë;
- 1.5. përgatitjen e raporteve ad hoc, periodike dhe vjetore mbi punën e agjencisë të cilat raporte i dorëzohen ministrit;
- 1.6. hartimin e planit vjetor dhe planit strategjik për administrimin efektiv dhe efikas të agjencisë.

### **Neni 11** **Përgjegjësit e Zëvendës Drejtorëve të Përgjithshëm**

Në mungesë të drejtorit të Përgjithshëm, zëvendës drejtori i kryen të gjitha detyrat e parapara në nenin 10 paragrafi 1, të këtij ligji, si dhe detyra tjera të caktuara nga drejtori i Përgjithshëm.

### **Neni 12** **Punësimi i personelit të Agjencisë**

1. Agjencia punëson dy kategori të personelit të saj:

- 1.1. zyrtarë të agjencisë që kryejnë detyra operative dhe profesionale në lëmin e menaxhimit të emergjencave;
- 1.2. staf civil që kryejnë shërbime mbështetëse dhe administrative;

2. Për zyrtarët nga nën-paragrafi 1.1. i këtij neni dhe detajet tjera lidhur me burimet njerëzore për këtë kategori, Ministri miraton akt-nënligjor.

### **Neni 13** **E drejta e pagës dhe shpërblimit**

Paga bazë, rritjet në paga, shtesat dhe dobitë e tjera, do të përcaktohen me akt nënligjor nga Ministri dhe do të përfshijnë shtesat, por nuk kufizohen në pagesa për rrezikshmërinë në punë, pagesa për punë jashtë orarit dhe gjatë festave, pagesa për shujtë ditore dhe pagesa për veshmbathje.

## **KREU III** **ORGANIZIMI, DHE PËRGJEGJËSITË E AGJENCISË**

### **Neni 14** **Organizimi**

1. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe lokal.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Agjencisë, është niveli qendror përgjegjës për tërë Republikën e Kosovës.
3. Niveli lokal përfshin Qendrat 112.
4. Për koordinimin e operacioneve të reagimit të një NJPZSH-vë, jashtë juridiksionit territorial të tyre, përgjegjës është Agjencia
5. Juridiksioni territorial i secilës Qendër 112 përcaktohet dhe propozohet nga drejtori i Përgjithshëm ndërsa miratohet nga ministri.
6. Drejtori i Përgjithshëm, me miratimin paraprak të ministrit, mund të themelojë njësi të posaçme në harmoni me kërkesat e vlerësimit të rreziqeve në nivel vendi.
7. Organizimi dhe struktura e brendshme organizative e agjencisë rregullohet me akt nënligjor, sipas Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës.

## **Neni 15**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë**

1. Agjencia kryen detyra menaxheriale dhe teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, veçanërisht në:

1.1. elaborimin e propozimeve për projekte zhvillimore dhe kërkimore;

1.2. elaborimin e propozimit për programin dhe planin kombëtar;

1.3. kujdeset për organizimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit, lajmërimit dhe alarmimit;

1.4. planifikimin, ngritjen, funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemit unik të komunikimit, informimit dhe përcaktimit të kushteve teknike për integrimin e sistemeve tjera;

1.5. elaborimin e vlerësimit të rreziqeve dhe dokumenteve teknike për planifikimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës si dhe drejtimin dhe koordinimin e masave për parandalim dhe lehtësimin e pasojave;

1.6. monitorimin dhe lajmërimin e rrezikut dhe dhënia e udhëzimeve për përballje me to;

1.7. hartimin e draft planeve kombëtare të reagimit emergjent në bashkëpunim me ministrinë dhe agjencinë qeveritare;

1.8. organizimin, pajisjen dhe trajnimin e strukturave qendrore të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, dhe strukturave tjera të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe krijimin e kushteve për funksionimin e strukturave organizative të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Emergjencave;

1.9. mbikëqyrjen dhe koordinimin e organizimit të SMSHN dhe shërbimeve tjera;

1.10. përgatitjen e planprogrameve, organizimin dhe realizimin e trajnimeve dhe aftësimit në fushën e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës;

1.11. klasifikimin e resurseve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë; dhe

1.12. krijimin dhe mirëmbajtjen e rezervave materiale kombëtare për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera;

1.13. Agjencia e Menaxhimit Emergjent, përgatit dhe shpërndan publikimet për informimin e komunitetit nga fusha e gatishmërisë emergjente si dhe zhvillon njoftimet për media publike



**Neni 16**  
**Bashkëpunimi ndërkombëtar**

1. Agjencia bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare të fushës së njëjtë dhe me institucionet e tjera të huaja, në bazë të legjislacionit në fuqi dhe sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.
2. Agjencia në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në bazë të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale ndërkombëtare, si dhe sipas nevojës mund të pranoj zyrtarë të huaj, përkatësisht të dërgoj zyrtarë të saj në shërbim të përkohshëm me qëllim të kryerjes së detyrave në lëmin e emergjencave.

**Neni 17**  
**Buxheti i Agjencisë**

1. Agjencia do të ketë linje të ndarë buxhetore e cila është në kuadër të buxhetit të ministrisë, dhe e miratuar në pajtim me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë përgatitë buxhetin e agjencisë, të cilin ia përcjellë ministrit për shqyrtim dhe procedim të mëtutjeshëm në përputhshmëri me procedurat e parapara me ligj.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë është përgjegjës për zbatimin dhe menaxhimin e buxhetit të agjencisë.
4. Të hyrat buxhetore të cilat krijohen nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent derdhen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

**KREU IV**  
**DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

**Neni 18**  
**Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Për zbatimin e këtij ligji ministri do të miratoj aktet nënligjore si në vijim:
  - 1.1. Rregulloren për themelimin, përbërjen dhe procedurat e komisionit për përzgjedhjen dhe propozimin e kandidatëve për drejtor të Përgjithshëm dhe zëvendës drejtor të Përgjithshëm të Agjencisë;
  - 1.2. Rregulloren për procedurat e punësimit, vlerësimit dhe kategorizimin e zyrtarëve të agjencisë së menaxhimit emergjent që kryejnë punë operative profesionale në lëmin e menaxhimit emergjent;

1.3. Rregulloren për pagën bazë dhe shpërblimet tjera sipas nenit 13 të këtij ligji

1.4. Rregulloren për flamurin, stemën dhe uniformën.

1.5. Rregulloren për detyrat operative dhe profesionale në lëmin e Menaxhimit Emergjent për Zyrtarët e Agjencisë.

2. Për zbatimin e këtij ligji, drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të miratoj aktet nënligjore si në vijim:

2.1. Rregullorja për organizimin dhe strukturën e brendshme organizative të Agjencisë së Menaxhimit Emergjent.

### **Neni 19 Aktet nënligjore**

Aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji, nxirren brenda afatit kohor prej gjashtë (6) muajsh, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 20 Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Udhëzimi Administrativ nr. 18/2010 për Organizimin dhe Strukturimin e Agjencisë së Menaxhimit Emergjent, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me këtë ligj.

### **Neni 21 Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/L-230  
27 shkurt 2014**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**